



# UNIVERSITETI SHTETËROR I TETOVËS

## STATE UNIVERSITY OF TETOVA - ДРЖАВЕН УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО

SUT Rectorate - Ilinden nn, 1200 Tetovo, Macedonia

Tel: +389 44 356 500; Fax: +389 44 334 222, email: international@unite.edu.mk

*Në bazë të nenit 108, 109 dhe 110 të Ligjit mbi Arsimin Sipëror të R.M (Fleta Zyrtare e R.M nr. 35/2008), Vendimit të Këshillit të Rektoratit nga mbledhja e mbajtur me 24.02.2011, **Rregullores për kushtet dhe kriteret për regjistrim** në studimet deridiplomike në USHT, dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për numrin e studentëve të cilët regjistrohen në Institucionet e arsimit të lartë në vitin akademik 2011/12 nr.51-1396/1, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për kuota plotësuese për regjistrimin e studentëve të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë në Institucionet e arsimit të lartë në vitin akademik 2011/12 nr.51-1397/1, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për plotësimin e vendimit për numrin e studentëve të cilët regjistrohen në Institucionet e arsimit të lartë në vitin akademik 2011/12 nr.51-2608/1 ("Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë nr. 27 të datës 03.Mars.2011 dhe Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë nr. 50 të datës 12.Prill.2011 ) Universiteti Shtetëror i Tetovës shpall:*

## K O N K U R S

**për regjistrimin e studentëve në studimet deridiplomike në programet studimore të  
Universitetit Shtetëror të Tetovës në vitin akademik 2011/2012**

**Tetovë, Prill 2011**

## I. Numri i studentëve

Në fakultetet e Universitetit Shtetëror të Tetovës, në studimet deridiplomike në vitin akademik 2011/12, në afatin e parë do të regjistrohen:

I	Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore		Të rregullt me	Shuma e pagesës	Të rregullt me	Shuma e pagesës	Me korrespondencë	Shuma e pagesës	Numri i
			kuotë shtetërore	për semestër (euro)	vetëfinansim	për semestër (euro)		për semestër (euro)	
Biologji	a) Drejtimi arsimor	65	0/100	30	200	/	/	95	
	b) Biokimi								
Kimi – Fizikë	Studime të disperzuara-Shkup	40	50	/	/	/	/	40	
	a) Drejtimi arsimor	25	0	/	/	/	/	25	
Fizikë	Studime të disperzuara-Shkup	40	50	/	/	/	/	40	
	a) Drejtimi arsimor	40	0/100	/	/	/	/	40	
Kimi	b) Drejtimi profesional	55	0/100	/	/	/	/	55	
	a) Drejtimi arsimor	40	0	/	/	/	/	40	
Matematikë	b) Drejtimi profesional	40	50	/	/	/	/	40	
	c) Biokimi analitike	40	50	/	/	/	/	40	
Informatikë	a) Drejtimi Arsivor	50	0/100	45	200	/	/	95	
	Studime të disperzuara-Shkup	40	50	/	/	/	/	40	
	Studime të disperzuara-Kërçovë	30	50	/	/	/	/	30	
	Studime të disperzuara-Kumanovë	40	50	/	/	/	/	40	
Gjeografi	a) Drejtimi arsimor	35	0/100	15	200	15	200	65	
	b) Drejtimi profesional								
<b>Gjithsej:</b>			<b>540</b>	<b>50/100</b>	<b>90</b>	<b>200</b>	<b>15</b>	<b>200</b>	<b>645</b>

II	Instituti për Ekologji dhe Teknologji		Të rregullt me	Shuma e	Të rregullt me	Shuma e	Me	Shuma e	Numri i
			kuotë shtetërore	pagesës për semestër	vetëfinansim	pagesës për semestër	korrespondencë	pagesës për semestër	
	Ekologji		40	100	20	200	/	/	60
<b>Gjithsej:</b>			<b>40</b>		<b>20</b>				<b>60</b>

II	Fakulteti Filozofik		Të rregullt me	Shuma e	Të rregullt me	Shuma e	Me	Shuma e	Numri i
			kuotë shtetërore	pagesës për semestër	vetëfinansim	pagesës për semestër	korrespondencë	pagesës për semestër	
Filozofi	a) Drejtimi arsimor	20	100	10	200	10	200	40	
	b) Drejtimi profesional								

Sociologji	a) Drejtimi arsimor	30	100	10	200	10	200	50
	b) Drejtimi profesional							
Histori	a) Drejtimi arsimor	30	100	10	200	10	200	50
	b) Drejtimi profesional							
Pedagogji	a) Pedagogji profesionale	45	100	15	200	20	200	80
	b) Grupi klasor							
	c) Grupi parashkollor							
Psikologji	a) Drejtimi arsimor	60	100	30	200	/	/	90
	b) Drejtimi profesional							
	Studime të disperzuara-Shkup	40	50	/	/	/	/	40
Orientalistikë	a) Drejtimi arsimor	10	100	5	200	5	200	20
	b) Drejtimi profesional							
<b>Gjithsej:</b>		<b>235</b>	<b>50/100</b>	<b>80</b>	<b>200</b>	<b>55</b>	<b>200</b>	<b>370</b>

IV	Fakulteti i Kulturës Fizike	Të rregullt me kuota shtetërore	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Të rregullt me vetëfinancim	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Me korrespondencë	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Nr. i përgjithshëm i studentëve
	Kultura Fizike	40	100	20	200	20	200	80
<b>Gjithsej:</b>		<b>40</b>	<b>100</b>	<b>20</b>	<b>200</b>	<b>20</b>	<b>200</b>	<b>80</b>

V	Fakulteti Filologjik	Të rregullt me kuota shtetërore	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Të rregullt me vetëfinancim	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Me korrespondencë	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Numri i përgjithshëm i studentëve
Gjuhë dhe letërsi shqipe	a) Drejtimi arsimor	30	100	10	200	20	200	60
	b) Përkthyes							
	c) Shkencor							
Gjuhë dhe letërsi angleze	a) Drejtimi arsimor	115	100	55	200	30	200	200
	b) Përkthyes							
	c) Shkencor							
	Studime të disperzuara– Dibër	80	50	20	50	20	200	120
	Studime të disperzuara-Shkup	80	50	/	/	/	/	80
	Studime të disperzuara-Kërçovë	30	50	/	/	/	/	30
Gjuhë dhe letërsi maqedone	Studime të disperzuara-Kumanovë	40	50	/	/	/	/	40
	a) Drejtimi arsimor	40	100	10	200	20	200	70
Gjuhë dhe letërsi gjermane	b) Përkthyes							
	c) Shkencor							
	Studime të disperzuara - Dibër	50	100	10	200	20	200	80
Gjuhë dhe letërsi frënge	Studime të disperzuara-Shkup	40	50	10	50	15	200	65
	Studime të disperzuara-Strugë	50	50					50
	Studime të disperzuara-Strugë	40	50	/	/	/	/	40
Gjuhë dhe letërsi frënge	a) Drejtimi arsimor	20	100	10	200	10	200	40
	b) Përkthyes							

	c) Shkencor							
	Studime të disperzuara - Dibër	55	50	10	50	15	200	80
Gjuhë dhe letërsi italiane	a) Drejtimi arsimor							
	b) Përkthyes	20	100	10	200	10	200	40
	c) Shkencor							
<b>Gjithsej:</b>		<b>690</b>	<b>50/100</b>	<b>145</b>	<b>50/200</b>	<b>160</b>	<b>200</b>	<b>995</b>

VI	Fakulteti i Arteve	Të rregullt me kuotë shtetërore	Shuma e pagesës për semestr (euro)	Të rregullt me vetëfinansim	Shuma e pagesës për semestr (euro)	Me korrespondencë	Numri i përgjithshëm i studentëve
	<b>Arti figurativ</b> a) Drejtimi arsimor b) Pikturë c) Dizajni grafik ç) Skulptura d) Grafikë	15	100	10	200	/	25
	<b>Arti muzikor</b> a) Drejtimet teorike-pedagogjike -Teoriko-pedagogjik -Kompozimi -Dirigjim koral -Muzikologji -Dirigjim orkestral -Etno-muzikologji b) Drejtimet vokalo-instrumentale - Solo këndim - Klarinet - Truba - Piano - Saksafon - Horni-Briri - Violona - Oboa - Tromboni - Viola - Kitara - Tuba - Violonçelo - Flauta - Fagot - Kontrabas	15	100	5	200	/	20
	<b>Arti dramatik</b> A. Aktrimi	20	100	10	200	/	30
<b>Gjithsej:</b>		<b>65</b>	<b>100</b>	<b>30</b>	<b>200</b>		<b>95</b>

VII	Fakulteti Juridik	Të rregullt me kuotë shtetërore	Shuma e pagesës për semestr (euro)	Të rregullt me vetëfinansim	Shuma e pagesës për semestr (euro)	Me korrespondencë	Shuma e pagesës për semestr (euro)	Numri i përgjithshëm i studentëve
	a) Drejtimi gjyqësor	95	100	75	200	30	200	200
	Studimet e disperzuara - Shkup	100	50	50	50	/	/	150
	Studimet e disperzuara - Kërçovë	100	50	30	50	/	/	130
	b) Drejtimi administrativ	15	100	35	200	30	200	80
	c) E drejta ndërkombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare	70	100	45	200	30	200	145
	Studimet e disperzuara - Shkup	70	50	/	/	/	/	70
	<b>Gazetari</b>	20	100	10	200	10	200	40
	Studime të disperzuara të Gazetarisë-Shkup	30	50	/	/	/	/	30
	Studime të disperzuara të studimeve politike - Shkup	50	50	/	/	/	/	50
<b>Gjithsej:</b>		<b>550</b>	<b>50/100</b>	<b>245</b>	<b>50/200</b>	<b>100</b>	<b>200</b>	<b>895</b>

VIII	Fakulteti Ekonomik		Të rregullt me kuotë shtetërore	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Të rregullt me vetëfinansim	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Me korrespondencë	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Numri i përgjithshëm i mi
Ekonomi	a) Financa dhe Kontabiliteti		80	100	70	200	20	200	170
	b) Menaxhmenti dhe marketingu		65	100	65	200	20	200	150
	c) Ekonomi dhe biznes		80	100	70	200	40	200	170
	Studimet e disperzuara - Strugë		120	50	35	50	/	/	155
	Studimet e disperzuara - Shkup		60	50	/	/	/	/	60
Turizëm	a) Turizmi i përgjithshëm		20	100	10	200	10	200	40
	b) Menaxhmenti turistik								
<b>Gjithsej:</b>			<b>425</b>	<b>50/100</b>	<b>250</b>	<b>50/200</b>	<b>70</b>	<b>200</b>	<b>745</b>

IX	Fakulteti i Shkencave Aplikative		Të rregullt me kuotë shtetërore	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Të rregullt me vetëfinansim	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Me korrespondencë	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Numri i përgjithshëm i studentëve
Ndërtimtari	a) Inxhinieri konstruktive		45	100	15	200	/	/	60
	b) Ndërtimtari, rrugë dhe infrastruktur.								
Arkitekturë	a) Projektim		65	100	35	200	/	/	100
	b) Urbanizëm		50	100	/	/	/	/	50
Mekatronikë			30	100	10	200	/	/	40
Inxhinieri ekonomike			20	100	10	200	/	/	30
<b>Gjithsej:</b>			<b>210</b>	<b>100</b>	<b>70</b>	<b>200</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>280</b>

X	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit		Të rregullt me kuotë shtetërore	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Të rregullt me vetëfinansim	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Me korrespondencë	Shuma e pagesës për semestër (euro)	Numri i përgjithshëm i studentëve
Teknologji ushqimore, dhe të ushqyerit			35	100	15	200	/	/	50
			35		15		/	/	50
<b>Gjithsej:</b>			<b>70</b>		<b>30</b>		<b>/</b>	<b>/</b>	<b>100</b>

XI	Fakulteti i Shkencave Mjekësore		Të rregullt me kuotë shtetërore	Shuma e pagesës për semestër	Të rregullt me vetëfinansim	Shuma e pagesës për semestër	Me korrespondencë	Shuma e pagesës për semestër	Numri i përgjithshëm i studentëve
Mjekësi e përgjithshme			30	100	40	200	/	/	70
Stomatologji			20	100	30	200	/	/	50
Farmacit			30	100	30	200	/	/	60
Infermieri									
a)Infermieri e përgjithsh. c) Logopedi			55	100	55	200	40	200	150
b) Akusheri d) Fizioterapi									
Fizioterapi – disperzime Dibër			70	50	20	50	20	200	110
<b>Gjithsej:</b>			<b>205</b>	<b>50/100</b>	<b>175</b>	<b>50/200</b>	<b>60</b>	<b>200</b>	<b>440</b>

XII	Fakulteti i Administratës së Biznesit		Të rregullt me kuotë shtetërore	Shuma e pagesës për semestër	Të rregullt me vetëfinansim	Shuma e pagesës për semestër	Me korrespondencë	Shuma e pagesës për semestër	Numri i përgjithshëm i studentëve
Administratë biznesi			220	100	110	200	/	/	330

Studime të disperzuara - Shkup	80	50	65	50	/	/	145
Studime të disperzuara - Kërçovë	100	50	40	50	/	/	140
<b>Administratë publike</b>	15	100	5	200	/	/	20
<b>Gjithsej:</b>	415	50/100	220	50/200	/	/	635

UNIVERSITETI SHETËTOR I TETOVËS	Të rregullt me kuotë shtetërore	Të rregullt me vetëfinancim	Me korrespondencë	Numri i përgjithshëm i studentëve
<b>Gjithsej:</b>	3485	1375	480	5340

### Vërejtje:

Njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar të cilët arsimin e tyre dëshirojnë ta vazhdojnë në programet studimore të disperzuara të USHT-së, se të njëjtat do të realizohen nëse në studimet e disperzuara paraqitet numër i mjaftueshëm i kandidatëve (më pak se 20 studentë për program studimor) atëherë studimet do të realizohen në fakultetet amë të USHT-së në Tetovë.

## II. Kushtet dhe kriteret për regjistrim

- Të drejtë regjistrimi për studime deridiplomike kanë kandidatët që kanë të kryer **shkollën e mesme katërvjeçare në shkollat e mesme të verifikuara** me akt të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës,  
 Përrjashtim bëjnë, personat me talent të veçantë, të cilët mund t'i regjistrojnë studimet në fakultetet e drejtimin të arteve edhe nëse nuk e kanë të mbaruar shkollën e mesme katërvjeçare, me kusht që atë ta kryejnë deri në fund të vitit të dytë të studimeve, në kushtet e përcaktuara sipas Statutit të Fakultetit.  
 Nëse personi nga paragrafi i mëparshëm nuk i plotëson kushtet e theksuara, e humb statusin e studentit në fakultetin përkatës.
- Kandidatët regjistrohen si studentë të rregullt të financuar nga shteti dhe studentë të rregullt me bashkëfinancim të studimeve.  
 Në studimet deridiplomike të fakulteteve mund të regjistrohen edhe studentë me korrespondencë, nëse këtë e mundëson karakteri i programit studimor.
- Në studime deridiplomike të fakulteteve mund të regjistrohen edhe kandidatë të cilët kanë të kryer arsimim të lartë apo sipëror, në fakultetet e ngjashme dhe shkollat e larta. Këta kandidatë regjistrohen jashtë kuotës, më së shumti deri në **10%** nga numri i përgjithshëm i studentëve të rregullt në fakultetin përkatës të përcaktuar në Konkurs.  
 Kandidatët nga paragrafi i mëparshëm regjistrohen sipas suksesit nga arsimimi i mëparshëm, përveç në programet studimore për të cilët, për shkak të specifikave nevojitet kontrollimi i talentit. Ngjashmërinë e vërtetojnë dhe e shpallin fakultetet.  
 Kandidatët nga kjo pikë regjistrohen me bashkëfinancim të studimeve, si dhe kandidatët nga kreu **V** i konkursit.
- Mënyra e seleksionimit të kandidatëve do të kryhet varësisht nga lloji i programeve studimore në të cilat konkurrojnë ata, edhe atë:
  - programe studimore ku seleksionimi i kandidatëve do të kryhet në bazë të suksesit nga arsimi i mesëm;
  - programe studimore ku seleksionimi do të kryhet në bazë të suksesit nga arsimi i mesëm dhe me kontrollim të talentit të kandidatëve. Kjo ka të bëjë me programet studimore me specifika të veçanta.
- Kriter bazë për seleksionimin e kandidatëve për regjistrim të studimeve deridiplomike është suksesi i arritur në arsim të mesëm, vlerësimi i suksesit të studentëve shprehet me pikë.
  - Në programet studimore ku seleksionimi kryhet vetëm përmes suksesit të arsimit të mesëm, kandidatët mund të fitojnë më së shumti **100 pikë**, edhe atë: suksesi i përgjithshëm në të gjitha lëndët merr pjesë me **60%**, ndërsa suksesi i arritur në maturën shtetërore merr pjesë me **40%**.

a. 1. Në programet studimore ku seleksionimi do të kryhet vetëm në bazë të suksesit të arritur në arsimin e mesëm, llogaritja e pikëve bëhet në këtë mënyrë: mblidhen të gjitha notat, të cilat janë të evidentuara në dëftesat e notave nga të gjitha vitet, shuma e përgjithshme e fituar pjesëtohet me numrin e notave, kështu që sukseksi mesatar i fituar shumëzohet me numrin **12**. Me këtë më së shumti mund të fitohen **60 pikë**.

a. 2. Llogaritja e pikëve të suksesit të arritur nga matura shtetërore bëhet në këtë mënyrë: rangimi sipas përqindjes nga provimi i lëndës eksterne, e cila jepet në maturën shtetërore shumëzohet me koeficientin 10. Në të njëjtën mënyrë llogaritet edhe përqindja e pikëve nga provimi i lëndës së dytë eksterne. Rangimi sipas përqindjes së provimit nga lënda interne e cila jepet në maturën shtetërore (Lista-1) shumëzohet me koeficientin 8. Në mënyrë të njëjtë llogaritet edhe rangimi i përqindjes nga lënda e dytë interne. Në këtë bazë mund të fitohen më së shumti **36 pikë**. Nota e fituar nga detyra e projektit shumëzohet me koeficientin **0,8**. Në këtë bazë mund të fitohen më shumti 4 pika. Sukseksi i përgjithshëm nga matura shtetërore më së shumti mund të sjellë **40 pikë**.

Për kandidatët të cilët shkollën e mesme e kanë mbaruar në vitet e mëparshme shkollore (para vitit shkollor 2007/2008) dhe nuk kanë mbaruar maturë shtetërore, përveç llogaritjes së pikëve nga pika 5. a. 1, llogariten edhe më së shumti **40 pikë** nga lëndët të cilët janë të rëndësishme për programin studimor, edhe atë: shuma e notave nga dy lëndë të rëndësishme për programin studimor dhe dy lëndët nga lëmia e gjuhëve (gjuhë amtare dhe një gjuhë botërore) pjesëtohet me 16, dhe kështu, sukseksi mestar i secilës lëndë veçmas shumëzohet me 8. Në këtë bazë mund të fitohen më së shumti **10 pikë** për një lëndë, përkatësisht **40 pikë** për katër lëndët.

b) Në programet studimore me specifika të veçanta, seleksionimi i kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit nga arsimi i mesëm dhe nga kontrollimi i talentit të kandidatëve. Kandidatët do të rangohen me mbledhjen e pikëve të fituara nga këto dy baza.

#### **Llogaritja e pikëve nga sukseksi i arsimit të mesëm:**

Në programet studimore nga fusha e arteve, arkitekturës dhe kulturës fizike: mblidhen të gjitha notat që janë përfshirë në dëftesat, nga të gjitha vitet, shuma e fituar pjesëtohet me numrin e notave dhe kështu, sukseksi mestar i fituar shumëzohet me 12. Në këtë bazë mund të fitohen më së shumti **60 pikë**.

#### **Llogaritja e pikëve nga kontrollimi i talentit të kandidatit:**

Në programet studimore nga fusha e arteve, arkitekturës dhe kulturës fizike, vlerësimi i suksesit nga kontrollimi i njohurive dhe aftësive të kandidatëve bëhet me fitimin nga **0** deri në **40 pikë**. Kontrollimi ka karakter eliminues. Nuk rangohen kandidatët të cilët kanë fituar më së paku **10 pikë**.

**Llogaritja e pikëve nga kontrollimi i njohurive dhe aftësive të kandidatëve nga këto kategori:** shtetas të huaj dhe kandidatë të cilët arsimin e mesëm e kanë mbaruar në vitet shkollore paraprake (para vitit shkollor 2007/2008) dhe nuk kanë mbaruar maturë shtetërore:

Në programet studimore mjekësi e përgjithshme, stomatologji, farmaci, kulturë fizike, art figurativ, muzikor, dramatik dhe arkitekturë, vlerësimi i suksesit nga kontrollimi i njohurive dhe aftësive të kandidatëve do të kryhet me fitimin e pikëve, nga **0** deri në **40 pikë**. Kontrollimi ka karakter eliminues. Nuk rangohen kandidatët të cilët kanë fituar më së paku **10 pikë**.

### **III. Seleksionimi i kandidatëve**

1. Për përcjelljen e realizimit të Konkursit, Rektorati formon Komision universitar të Konkursit.
2. Për llogaritjen e pikëve nga sukseksi i arritur nga arsimi i mesëm dhe nga sukseksi i maturës shtetërore ose maturës shkollore, Rektorati formon Komisione të konkursit për secilin fakultet veçmas, ndërsa programet studimore nga fusha e arteve, arkitektura dhe kultura fizike formojnë Komisione edhe për kontrollimin e talentit.  
Komisioni universitar i Konkursit e përcjell realizimin e Konkursit, kujdeset për respektimin e përpiktë të dispozitave të Konkursit, jep udhëzime dhe mendime në procesin e realizimit të tij.

3. Rangimin e kandidatëve e kryejnë Komisionet e veçanta të fakulteteve.
4. Komisioni për Konkurs, në tabelat e shpalljeve të fakultetit e shpall rangimin sipas poenave nga sukcesi i arsimit të mesëm (suksesin mesatar), dhe nga rezultatet e kontrollimit të talentit nga programet studimore në të cilat ai zbatohet.  
Pas shpalljes së rang listës preliminare të kandidatëve për regjistrim nga Komisioni për Konkurs, kandidati ka të drejtë për kundërshtim në afat prej 24 orësh. Në të kundërtën, e humb të drejtën për kundërshtim në procedurën e mëtejme të ankesave për rezultatet e shpallura.  
Kundërshtimi ka të bëjë vetëm me lëshimet teknike-gabime të bëra gjatë llogaritjes së pikëve, dhe i njëjti i drejtohet Dekanatit të Fakultetit.  
Aktvendimi i Dekanatit është përfundimtar. Vendimet për kundërshtimet shpallen në fakultet. Pas skadimit të afatit për parashtrimin e kundërshtimeve dhe shqyrtimit të tyre, Komisioni universitar i Konkursit në fakultetin përkatës shpall Aktvendim për pranimin e studentëve (**Rang lista përfundimtare**), në bazë të së cilës bëhet regjistrimi i studentëve. Kandidatët e pranuar si dhe ato të cilët nuk janë pranuar, pas shpalljes së Aktvendimit për pranim, nuk kanë të drejtë kundërshtimi ose ankimi.  
***Kandidatët të cilët në afatin kohor të paraparë për regjistrim nuk do të bëjnë regjistrim, respektivisht nuk do të dorëzojnë dokumentacionin e duhur për regjistrim (kreu VIII i Konkursit – Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim) ose fare nuk do të paraqiten në shërbimet studentore në fakultetin në të cilin janë pranuar, do të konsiderohet se kanë hequr dorë nga vendi dhe vendi i tyre do të shpallet si i lirë në Konkursin plotësues.***
5. Fakultetet në të cilët edhe pas përfundimit të afatit të parë të regjistrimit do të mbeten vende të paplotësuara, bëjnë regjistrim të studentëve në afatin e dytë dhe të tretë regjistrues.
6. Nëse në afatin e parë regjistrues, gjatë rangimit, në fund të listës së kandidatëve të pranuar ka më shumë kandidatë me numër të barabartë të pikëve (më së shumti pesë kandidatë), fakulteti i regjistron të gjithë kandidatët e tillë. Por, nëse numri i kandidatëve të tillë është më i madh se 5 (pesë), atëherë fakulteti kandidatët e tillë i rangon sipas kritereve plotësuese: përshtatshmëria e projekt detyrës së punuar gjatë dhënies së provimit të maturës shtetërore, çmimet e fituara në garat republikane dhe ndërkombëtare, anëtarë të reprezentacioneve sportive të Republikës së Maqedonisë, certifikatat e fituara për njohje të gjuhëve të huaja në nivel më të lartë etj.
7. Studentët në kuotën shtetërore regjistrohen duke paguar kompensim për bashkëfinancim të studime, të përcaktuar si në kreun I të Konkursit në kundërvlerë në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RM. Kompensimi për studime të studentëve nga paragrafi paraparak, për secilin program studimor në veçanti, është pjesë përbërëse e këtij konkursi. Pagesa e kompensimit kryhet në dy këste të barabarta.  
Kompensimi nga paragrafit 1 i kësaj pike, studentët e dorëzojnë për çdo semestër sa zgjasin studimet e tyre.
8. Drejtoria e Rektoratit sjell Udhëzim të veçantë për realizimin e Konkursit.

#### IV. Regjistrimi i studentëve me korrespondencë

1. Në programet studimore të veçanta në fakultete, si student me korrespondencë mund të regjistrohen kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për regjistrim dhe kanë kontratë për punësim në kohë të pacaktuar, si dhe kandidatët të cilët për shkaqe të arsyeshme nuk kanë mundësi të regjistrohen si studentë të rregullt. Si shkaqe të arsyeshme nga paragrafi paraparak llogariten: invalid, i cili nuk është në gjendje ta ndjek mësimin e rregullt; sëmundje e rëndë afatgjate, e cila pamundëson vijimin e rregullt të mësimin më tepër se një semestër; prind i fëmijës deri sa zgjatë pushimi i lehonisë.
2. Studentët me korrespondencë regjistrohen sipas kushteve dhe kritereve të njëjta si studentët e rregullt, ndërsa rangohen në lista të veçanta të rangimit.  
Studentët me korrespondencë regjistrohen me vetëfinancim të studimeve, sipas shumës së paraqitur në tabelën nr. I.



3. Gjatë paraqitjes për regjistrim, si studentë me korrespondencë, kandidatët dorëzojnë dëshmi për punësim në kohë të pacaktuar, ose vërtetim mjekësor për shkaqet e theksuara në pikën 1, paragrafi 2.

#### V. Regjistrimi i studentëve me bashkëfinancim të studimeve

1. Në fakultetet, si studentë të rregullt regjistrohen edhe kandidatë që i plotësojnë kushtet për regjistrim, ndërsa për shkak të kufizimit të kuotave nuk mund të regjistrohen në kategorinë e studentëve të financuar nga shteti.
2. Studentët që regjistrohen në këtë kategori, shumën e përcaktuar në kreun I të Konkursit e paguajnë në kundërvlerë të denarit, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RM-së, në ditën e pagesës, në së paku 2 këste të barabarta.
3. Fakulteti shpall listën e rangimit të kandidatëve që i plotësojnë kushtet për regjistrim në këtë kategori. Kandidatët që pajtohen të regjistrohen në këtë kategori studentësh, dorëzojnë deklaratë në afat prej 24 orësh pas shpalljes së listës përfundimtare të rangimit, se pajtohen gjatë gjithë kohës së studimeve të marrin pjesë në bashkëfinancim të studimeve.  
Listën e kandidatëve të pranuar në këtë kategori e vërteton Komisioni i Konkursit në bazë të listës së rangimit dhe deklaratave të dorëzuara për pajtueshmëri për regjistrim në këtë kategori.  
Studentët me bashkëfinancim gjatë regjistrimit lidhin kontratë me fakultetin, për të drejtat dhe obligimet e ndërsjella në realizimin e procesit edukativo-arsimor.

#### VI. Kandidatët me arsim të mesëm të kryer jashtë vendit

##### a) Shtetasit e huaj

1. Shtetasit e huaj regjistrohen jashtë kuotave të përcaktuara në Konkurs.
2. Seleksionimi i shtetasve të huaj që paraqiten për studim në programet studimore të Mjekësisë së përgjithshme, Stomatologjisë, Farmacisë, Arkitekturës, Kulturës fizike, Artit dramatik, figurativ dhe muzikor, **kryhet me anë të kontrollit të diturive dhe aftësive.**
3. Gjatë paraqitjes, kandidatët e theksojnë në cilin fakultet, respektivisht program studimor dëshirojnë të studiojnë, se a janë bursistë të qeverisë së tyre, apo vetë i bartin shpenzimet e studimeve. Me fletëparaqitje dorëzojnë diplomë për mbarimin e arsimit të mesëm, si dhe dëftesa për të gjitha klasat, përkthim të vërtetuar të certifikatës së lindjes, vërtetim për njohje të gjuhës maqedonase (të dhënë nga komisioni i Universitetit), dhe certifikatë për gjendjen shëndetësore (nga Poliklinika Universitare). Shtetasit e huaj, diplomën për mbarimin e shkollës së mesme, si dhe dëftesat për të gjitha klasat, duhet t'i nostrifikojnë gjatë vitit të parë të studimeve. Kandidatët të cilët kanë të kryer shkollën e mesme fetare – Medresenë jashtë Republikës së Maqedonisë nuk mund të aplikojnë për regjistrim në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Universiteti organizon kurs për mësimin e gjuhës shqipe dhe maqedonase.

Pagesa e studimeve për shtetasit e huaj në fakultete dhe studime të disperzuara, për vitin shkollor 2011/2012 është në shumë prej **200 euro për një semestër** respektivisht 400 për një vit akademik, përveç në programin studimor Mjekësi e përgjithshme, Stomatologji dhe Farmaci, në të cilat pagesa e shkollimit është në shumë prej **1000 euro** respektivisht 2000 për një vit akademik, nëse nuk është rregulluar ndryshe me kontratë për bashkëpunim të ndërsjellë mes universiteteve. Në këtë kategori të studentëve bëjnë pjesë edhe kandidatët, shtetas të huaj, prindërit e të cilëve apo vetë ata punojnë në përfaqësitë diplomatike në Republikën e Maqedonisë.

Shtetasit e huaj e mbajnë statusin e njëjtë deri në diplomim.

##### b) Mërgimtarët dhe shtetasit e RM-së me arsim të mesëm të kryer në tërësi dhe me arsim të mesëm të kryer pjesërisht jashtë vendit

1. Kandidatët, prindërit e të cilëve janë mërgimtarë tanë dhe kandidatët shtetas të RM, që **arsimin e mesëm të plotë** e kanë kryer jashtë vendit regjistrohen jashtë kuotave, me bashkëfinancim të studimeve.
2. Seleksionimi i kandidatëve nga pika 1, në programet studimore të Mjekësisë së përgjithshme, Stomatologjisë, Farmacisë, Arkitekturës, Kulturës fizike, Artit dramatik, figurativ dhe muzikor, **kryhet me kontrollim të njohurive dhe aftësive**.
3. Kompensimi për studime i kësaj kategorie të studentëve, në varësi të programeve studimore, është përcaktuar në kreun I të Konkursit (si për kandidatët nga kreu V).  
Kandidatët nga paragrafi i parë, mund të regjistrohen edhe sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Konkurs për kandidatët me arsim të mesëm të kryer në RM, në kuadër të kuotës shtetërore.

Kandidatët nga pika 1, bashkë me fletëparaqitjen dorëzojnë diplomë të nostrifikuar si dhe dëftesa të nostrifikuara për katër vitet e kryera të arsimit të mesëm jashtë vendit.

4. Kandidatët shtetas të RM-së, që **një pjesë të arsimit të mesëm** e kanë kryer jashtë vendit dhe kandidatët me maturë të mbaruar ndërkombëtare, regjistrohen me kushte dhe kritere të njëjta, si dhe kandidatët me shkollë të mesme të mbaruar në Republikën e Maqedonisë, me atë që përveç dokumenteve të tjera, dorëzojnë edhe dëftesa të nostrifikuara për pjesën e arsimit të mesëm të kryer jashtë vendit, përkatësisht me maturë të kryer ndërkombëtare.

Këta kandidatë rangohen në rang - listë të veçantë, kurse do të pranohen ata kandidatë të cilët do të fitojnë aq pikë, të paktën sa edhe kandidati i fundit i pranuar në kuadër të kuotës shtetërore në programin studimor përkatës. Numri i këtyre kandidatëve mund të arrijë më së shumti **10%**, kurse shpenzimet për studimet e tyre i bart Ministria për Arsim dhe Shkencë.

Kandidatët të cilët kanë fituar pikë, të paktën sa edhe kandidati i fundit i pranuar në kategorinë me bashkëfinancim të studimeve, regjistrohen me kompensim për studime në lartësi të përcaktuar sipas kreut I të Konkursit. Për kandidatët të cilët regjistrohen në këtë kategori, me bashkëfinancim të studimeve, vlejné dispozitat nga kreu V i Konkursit.

Kandidatët nga kreu i VI, paraqiten në Rektoratin e USHT-së, në afatet e përcaktuara me Konkurs.

#### **VII. Kandidatët me të drejta të veçanta të përcaktuara sipas ligjeve të RM si dhe kandidatët të cilët pranohen në kuadër të kuotës së bashkësive të cilët nuk janë shumicë në R. Maqedonisë.**

1. Numri i studentëve, që i takojnë kategorisë së personave me të drejta të veçanta të përcaktuara me Ligjin për të drejta të veçanta të RM, regjistrohen në kuotë të veçantë (pa bartje të shpenzimeve për studime), numri i tyre mund të arrijë më së shumti 10% nga numri i përgjithshëm i studentëve në nivel të programit studimor.
2. Për sigurimin e përfaqësimit të drejt të kandidatëve të cilët u takojnë bashkësive të cilët nuk janë shumicë në R.Maqedonisë, në institucionet e larta të Universitetit, në vitin akademik 2011/12, në mënyrë plotësuese do të regjistrohen kandidatët të cilët u takojnë këtyre bashkësive, numri i të cilëve të mos e kalon 10 % nga numri i përgjithshëm i studentëve të cilët regjistrohen në vitin e parë në nivel të fakultetit. Në kuadër të kësaj përqindjeje, në mënyrë të drejtë do të përfaqësohen kandidatët e të gjitha bashkësive, deri në përqindje me të cilin bashkësia përkatëse është përfaqësuar në numrin e përgjithshëm të banorëve në R.Maqedonisë.

#### **VIII. Afatet për paraqitje, kontrollimin i njohurive dhe aftësive dhe regjistrimi**

REALIZIMI I KONKURSIT PËR REGJISTRIM TË STUDENTËVE – 2011/12	Afati i I i regjistrimit		Afati i II i regjistrimit	
	LLOJI I PROGRAMEVE STUDIMORE			
	me kontroll të njohurive dhe aftësive	pa kontroll të njohurive dhe aftësive	me kontroll të njohurive dhe aftësive	pa kontroll të njohurive dhe aftësive
Paraqitja e kandidatëve	16 deri 19 gusht	16 deri 19 gusht	01 deri 03 shtator	01 deri 03 shtator
Kontrollimi i njohurive dhe aftësive	20-21 gusht	/	04 shtator	/

Shpallja e listës preliminare	22 gusht	22 gusht	05 shtator	05 shtator
Shpallja e vendimit për pranim të kandidatëve	24 gusht	24 gusht	07 shtator	07 shtator
Regjistrimi i kandidatëve	24 deri 30 gusht	24 deri 30 gusht	07 dhe 10 shtator	07 dhe 10 shtator

Në afatin e dytë dhe të tretë të regjistrimit, në fakultetet në të cilat do të ketë vende të lira, të drejtë konkurimi do të kenë kandidatët të cilët i janë nënshtruar dhe me sukses e kanë kaluar maturën shtetërore, por kanë zgjedhur lëndë interne të cilët nuk janë kompatible me lëndët të cilët figurojnë në Listën 1 nga Konkursi, si dhe kandidatët të cilët me sukses e kanë kaluar maturën shkollore.

